

PARAQITJA E SHQIPTARËVE NË MEDIAN GJERMANE

Dr. Linda Mëniku

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
Universiteti i Tiranës
E-mail: linda.meniku@unitir.edu.al

Dr. Iris Luarasi

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
Universiteti i Tiranës
E-mail: iris.luarasi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Emigracioni është një nga temat qendrore në diskursin publik evropian, veçanërisht që nga e ashtuquajtura “kriza evropiane e refugjatëve”. Mediat e (ri)prodhojnë këtë diskurs dhe, si rrjedhim, luajnë një rol thelbësor në ndërtimin e realiteteve shoqërore.

Shqipëria ka aktualisht shkallën më të lartë të emigrimit në Evropën Qendrore dhe Lindore, në raport me popullsinë e saj. Gjatë viteve të fundit, ka një rritje të numrit të emigrantëve shqiptarë drejt Gjermanisë, për shkak të nivelit të lartë ekonomik dhe shoqëror dhe mundësive të punësimit që ky vend ofron.

Duke përdorur një qasje inovative të Analizës Kritike të Diskursit, të mbështetur dhe në të dhënat e Korpusit Gjuhësor, në këtë punim synohet të hulumtohen strategjitë diskursive të përdorura nga media gjermane online për mënyrën e paraqitjes së shqiptarëve dhe, si rrjedhojë, dhe të imazhit që mediat ndërtojnë për ta në publik.

Në këtë punim, do të analizojmë diskursin për emigrantët në një nga mediat gjermane më me ndikim, në tabloidin *Bild*. Të dhënat u mblodhën nga faqen e internetit *www.bild.de* për periudhën janar-dhjetor 2022.

Ky punim trajton mënyrën e përfaqësimit të shqiptarëve në një nga mediat gjermane më të ndjekura, dhe rezultatet tregojnë se media luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e imazhit pozitiv apo negativ të emigrantëve.

Fjalët çelës: *emigrantë, shqiptar, shqip, Shqipëri, Analiza Kritike e Diskursit, tituj, media*

Hyrje

Që nga viti 1990, një e treta e popullsisë së Shqipërisë është larguar nga vendi drejt Italisë, Greqisë, Gjermanisë, SHBA-së, Kanadasë etj. Sipas IOM-it, Shqipëria ka aktualisht shkallën më të lartë

të emigrimit, në raport me popullsinë e saj, në Evropën Qendrore dhe Lindore¹. Sipas të dhënave të Eurostat-it, në vitin 2021 rreth 433 mijë shqiptarë jetonin në Itali, 77 000 në Gjermani, 110 000 mijë në Francë dhe rreth 21 mijë shtetas shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar.² Në vitin 2021, popullsia shqiptare e regjistruar në Gjermani ishte gati 77 mijë persona, apo gati tre herë më e lartë se në 2015-ën, përpara se të rifillonte cikli i ri i emigracionit.³

Për vitin 2022 janë 10650 shqiptarë që kanë kërkuar azil në vendet e Bashkimit Europian, duke përbërë 1,8% të numrit total të azilkërkuesve.⁴ Sipas të dhënave të Open Data Albania⁵, azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së patën si destinacion kryesor Francën në vitet 2012-2013 dhe 2017-2022, ndërsa në vitet 2014-2016 Gjermaninë. E njëjta prirje është dhe në vitin 2022, ku numri më i lartë i kërkesave për azil ka qenë në Francë dhe në Gjermani.

Tabela 1. Numri i azilkërkuesve shqiptarë sipas shteteve të BE-së (2012-2022)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Gjermania	230	1,245	7,865	53,805	14,855	3,775	1,875	1,695	815	1,210	1,745
Franca	2,645	5,015	2,845	3,220	6,945	11,425	8,555	8,510	2,010	4,885	5,690
Greqia	385	580	555	915	1,300	2,345	3,125	2,795	1,025	1,125	885
Suedia	1,495	1,110	1,635	2,565	730	685	570	490	190	145	170
Italia	65	115	175	425	365	465	1,290	1,545	450	760	1,280
Belgjikë	605	475	495	610	650	670	505	540	270	440	445
Holanda	15	30	85	1,005	1,665	365	550	190	80	55	50
Irlanda	45	50	100	215	220	280	460	970	40	65	220

Në vitin 2022, në Gjermani 20,2 milionë persona që jetonin në Gjermani kishin histori emigrimi. Bazuar në rezultatet e mikroregjistrimit, Enti Federal i Statistikave raporton se kjo ishte një rritje prej 1.2 milionë, ose 6.5 përqind, krahasuar me një vit më parë (2021: 19.0 milionë).⁶

Sipas zyrtarëve gjermanë, gjatë dimrit të vitit 2022, qytetet gjermane u përballën me një numër të shtuar emigrantësh nga Ballkani

1. <https://albania.iom.int/migration-and-albania>.

2. <https://www.statista.com/statistics/1253252/albanian-population-in-united-kingdom>.

3. Eurostat: Rreth 110 mijë shqiptarë jetojnë në Francë e Gjermani - Shqiptarja.com.

4. <https://politiko.al/english/e-tjera/shqiptaret-perbejne-18-te-totalit-te-azilkerkuesve-ne-be-kryeson-franca-i477936>.

5. Ibid.

6. 24.3% of the population had a history of immigration in 2022 - German Federal Statistical Office (destatis.de)

Perëndimor: “Rreth 40 për qind e refugjatëve vijnë nga Ukraina, dhe kombësitë e tjera përbëjnë 60 për qind të tyre. Pjesa më e madhe vijnë nga Shqipëria.”⁷

Gjermania është, po ashtu, vendi me diasporën më të madhe të shqiptarëve të Kosovës në botë. Sipas Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, në Gjermani jetojnë më shumë se 350 mijë kosovarë.⁸

Qasja teorike

Si një nga vendet me një numër të lartë emigrantësh, hapësira e diskursit gjerman për migracionin ofron mundësi të shumta në këtë drejtim.

Në këtë punim, diskursi i medias gjermane për emigracionin shqiptar do të studiohet duke përdorur teorinë dhe kornizat metodologjike të dhëna nga Analiza Kritike e Diskursit (CDA).

CDA-ja përkufizohet gjerësisht si një qasje e cila përdoret për hulumtimin e gjuhës dhe kontekstit të përdorimit të gjuhës (Wodak&Meyer, 2001). Studimet kritike të diskursit (CDA) fokusohen në një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë identitetin kombëtar, diskriminimin, racizmin dhe paragjykimet (De Cillia et al., 1999; Reisigl & Wodak, 2001), si dhe riprodhimin e marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit dhe diskriminuese, ideologjitë raciste dhe seksiste (Van Dijk, 1993).

Diskursi për emigracionin është gjithashtu një temë e rëndësishme kërkimore për analistët e diskursit kritik (Van Dijk, 1984, 1987, 1991, 1993; Wetherell & Potter, 1992; Wodak & Van Dijk, 2000; Wodak et al, 1990; Wodak & Richardson, 2012; Zapata-Barrero, 2009; Zapata-Barrero & Van Dijk, 2007).

Brenda kuadrit të CDA-së, studiesit (Van Dijk, 1987, 1991; Wodak 1996) kanë nxjerrë në pah faktin se emigrantët nuk zënë një vend të mjaftueshëm në media, madje dhe portretizohen si shkelës të ligjit.

Në studimet e tij të hershme, Van Dijk (1984) analizoi mënyrën e përfaqësimit të emigrantëve dhe të refugjatëve në Holandë, dhe proceset e formimit të diskriminimit për emigrantët (1987), duke ilustruar rolin e medias në riprodhimin e diskurseve dhe në perceptimin

7. <https://www.euronews.com/my-europe/2023/03/09/german-cities-struggling-with-winter-influx-of-migrants>.

8. <https://www.auswaertiges-amt.de/en/aussenpolitik/kosovo/228088>.

publik. Sipas Van Dijkut (2017:18) *“një analizë sistematike e mënyrës se si aktorët përshkruhen në diskursin e emigracionit ofron një pasqyrë në qëndrimet themelore në lidhje me emigrantët.”*

Studimet e bëra nga Van Dijk (1987, 1991; Wodak, 1996b; van Leeuën & Jaëorski, 2003) nxorën në pah faktin që migrantët ose pakicat nuk zinin një vend të mfafueshëm në media, njësoj si të tjerët, madje dhe portretizoheshin si shkelës të ligjit dhe si njerëz që krijojnë probleme dhe si të padëshirueshëm. Leader 2007 (cituar nga Seeliger 2018) thekson se emigrantët portretizohen shpesh si njerëz “të varfër, të paarsimuar dhe ndoshta terroristë”.

Sipas Van Dijkut (2017), në analizimin e diskursit të emigracionit është e rëndësishme të përqendrohemi në struktura të ndryshme të vetë tekstit, duke filluar nga analizimi i temave, pra kuptimi i tyre i përgjithshëm. Po ashtu, Van Dijk i jepet një vend të veçantë analizës së titujve të lajmeve, pasi titujt janë elementet e para të një teksti që tërheqin vëmendjen e audiencës.

Van Dijk (2015:18), po ashtu konsideron si shumë të rëndësishme që analiza cilësore dhe kritike e aktorëve të ndryshëm në diskursin e migracionit të mund të shtjellohet më tej nga një qasje më sasiore, duke përdorur frekuencat e përdorimit të fjalëve.

Kështu, në kuadrin e gjuhësisë së korpusit, Baker (2012), analizon se si dhe sa shpesh një fjalë bashkohet me fjalë të tjera në të njëjtat rreshta të dhënash të një korpusi, për shembull nëse fjala “emigrant” zakonisht shoqërohet fjalën me “i paligjshëm”.

Bazuar në studimin e Baker et al. (2008), studimet për emigracionin që bazohen në Analizën Kritike të Diskursit dhe gjuhësisë së korpusit janë shtuar gjatë viteve të fundit. Burimet kryesore të të dhënave janë kryesisht nga media, sepse media është mjete që përdorin autoritetet për të imponuar ligjet e tyre dhe vepron brenda komuniteteve shoqërore (Van Dijk, 1996). Gjuhësia e korpusit fokusohet në studimin e fjalëve kyçe dhe konkordancave në këto tekste.

Për të pasur një panoramë më të qartë në lidhje me diskursin për shqiptarët në median, në këtë punim është përdorur Analiza Kritike e Diskursit (CDA) dhe, krahas saj, është përdorur dhe gjuhësia e korpusit, apo analiza e korpusit gjuhësor.

Studimi

Sikurse u theksua më lart, ky studim bazohet në Analizën Kritike të Diskursit (CDA) dhe analizon strategjitë e përdorura nga media gjermane për paraqitjen e emigrantëve shqiptarë. Ne kemi analizuar tematikat e lajmeve për shqiptarët dhe mënyrën e paraqitjes së tyre.

Mënyra e paraqitjes së emigrantëve reflekton dhe qëndrimet politike të medias. Për këtë qëllim, ne monitoruam tabloidin *Bild*, që është një tabloid kombëtar dhe gazeta me tirazhin më të madh në Gjermani. *Bild* i përket grupit botues *Axel Springer*. Tabloidi *Bild* është përshkruar si “i njohur për përzierjen e thashethemeve, gjuhës nxitëse dhe sensacionalizmit”⁹ dhe se ka një ndikim të madh te politikanët gjermanë dhe faja e lajmeve në internet *Bild.de* më e përdorura në Gjermani.

Maurer et al., në një studim pesëvjeçar në lidhje me raportimin në media për refugjatët dhe emigracionin, kanë arritur në përfundimin se ashtu si dhe mediat e tjera në Gjermani, dhe *Bild* trajton tema që lidhen me kriminalitetin e emigrantëve dhe terrorizmin. Në krahasim me mediat si *Frankfurter Allgemeine Zeitung* (FAZ) dhe *Süddeutsche Zeitung*, në të cilat kriminaliteti i refugjatëve dhe terrorizmi zënë 10 për qind të raportimeve të përgjithshme, këto raportime në *Bild* shkojnë deri në masën 25 për qind.¹⁰

Sipas një studimi të bërë nga Hesterman (2019) për raportimet për emigrantët në media, rezulton se tabloidi *Bild* “është i fokusuar konkretisht mbi rreziqet e emigracionit” dhe rrallëherë u jep zë emigrantëve.

Valën e madhe të emigracionit në Gjermani, mediat në Gjermani e paraqitën me nota pozitive, përveç tabloidit *Bild*, që në këto studime rezultoi të ishte media me raportimin më negative për refugjatët, duke u fokusuar shumë shpesh te kriminaliteti i refugjatëve dhe pasojat negative për sigurinë e brendshme të Gjermanisë.¹¹

Në këtë studim, përmes kërkimit të fjalëve kyç *Albaner, Albanien, Albanisch* në fushën e kërkimit në faqen e internetit www.bild.de u mbledh një korpus, i përbërë nga 74 artikuj të botuar nga 1 janari 2022 deri më 31 dhjetor 2022. Përzgjedhja e kësaj periudhe u bë për shkak të numrit në rritje të emigrantëve shqiptarë në Gjermani gjatë këtij viti.

9. http://www.fact-index.com/b/bi/bild_zeitung.html.

10. Mauer M., Jost P., Kruschinski S., Haßler Fünf Jahre Medienberichterstattung über Flucht und Migration. F.3. Policy_Paper_Migration.indd (stiftung-mercator.de)

11. Ibid.

Analiza e të dhënave bazohet në një përmbledhje të numrit të artikujve që përmbajnë fjalët *shqiptar*, *Shqipëri*, *shqip* (në gjuhën gjermane), për të treguar intensitetin e artikujve që kanë në fokus shqiptarët në tabloidin *Bild*. Për këtë studim u përdor programi i analizës së tekstit: *Concordance*, 3.2.

Rezultatet

Bazuar në analizën e titujve të artikujve të mbledhur nga *Bild* mund të thuhet se fjala *Albaner* (shqiptar) gjendet në 8 nga 74 titujt e analizuar ose në 10 për qind të rasteve, fjala *Albanien* (Shqipëri) në 3 tituj ose e shprehur në përqindje në 4 për qind të titujve dhe *Albanisch* vetëm në një titull ose 1.35 për qind të titujve. Pra sikurse, shihet mbizotëron emërtimi sipas kombësisë. Në një nga këta tituj, në fakt, përdoret termi *Kosovo-Albaner* (shqiptar i Kosovës).

Table 1. Numri i titujve që përmbajnë fjalët *Albanien*, *Albaner*, *Albanisch*

	Albanien	Albaner	Albanisch
Nr.	3	8	1

Sikurse dihet, mediat raportojnë mbi ngjarjet aktuale, të cilat përfshijnë fusha të ndryshme të jetës, nga politika e deri te kultura, dhe mund të jenë të karakterit lokal, rajonal ose me shtrirje më të gjerë, si në rastin e ngjarjeve me rëndësi botërore.

Në këtë studim, temat për raportimin në media janë ndarë në disa kategori: situata në Kosovë, kriminaliteti, sporti, ekonomia, bazuar në titujt dhe në përmbajtjen e artikujve.

Tabela 2. Temat në raportimin në *Bild* për shqiptarët (titujt)

Tema	Albaner	Albanien	Albanisch	Kosovo
Situata në Kosovë				4
Krimet kundër shqiptarëve	2			
Krimet e shqiptarëve	4			
Sporti	1		1	
Lajme nga Shqipëria		3		
Ekonomi	1			

Sikurse shihet nga Tabela 2, fjala *Albaner* (shqiptar) zë vendin kryesor në titujt e lajmeve që kanë si temë krimet e shqiptarëve. Duhet të theksojmë faktin se fjala *Albanien* (Shqipëri) në tituj gjendet e përdorur, kryesisht në raportimet e lajmeve për Shqipërinë.

Për të pasur një panoramë më të qartë të interesimit të tabloidit *Bild* për Shqipërinë apo për shqiptarët, do ta shtjellojmë më tej analizën tonë përmes një qasjeje më sasiore, duke përdorur frekuencat e përdorimit të fjalëve kyç që kemi marrë në analizë: *Albaner*, *Albanien*, *Albanisch*, në përmbajtjen e artikujve të analizuar.

Nga analiza e përmbajtjes së lajmeve, mund të arrijmë në përfundimin se shqiptarët përmenden kryesisht në lajme për krimet ku ata janë përfshirë 34 artikuj apo në 46 për qind të rasteve, pasuar nga artikujt për sportistët shqiptarë (17 artikuj ose 23 për qind të lajmeve) dhe artikujt për zgjerimin e BE-së (11 artikuj ose 15% të artikujve). Një pasqyrim më i detajuar i tematikës së lajmeve të tabloidit *Bild* ku përmenden fjalët *shqiptar*, *shqip*, *Shqipëri* jepet më poshtë në Tabelën 3.

Tabela 3. Temat në raportimin në *Bild* për shqiptarët

Tema	Nr.
Situata në Kosovë	5
Krimet kundër shqiptarëve	2
Krimet e shqiptarëve	34
Sporti	17
Zgjerimi i BE-së	11
Lajme nga Shqipëria	3
Ekonomi	1
Gjuha	1

Në një analizë më të detajuar për raportimin e krimeve ku janë përfshirë shqiptarët, mund të themi se numri më i madh i lajmeve është në lidhje me përfshirjen e shqiptarëve në trafikun e drogës (6), për vrasje (16), për mashtrim ekonomik dhe pastrim parash (7), vjedhje në bankë (1), transportim i paligjshëm i kafshëve (1) etj.

Sipas një dokumenti të Komisionit për Barazi dhe kundër Diskriminimit Racor të BE-së¹², toleranca dhe vlerësimi për diversitetin kushtëzohen shumë nga perceptimet e opinionit publik për emigrantët dhe pakicat etnike, të cilat në thelb formohen nga media. Prandaj, rekomandimi i këtij Komisioni për mediat, kur ato raportojnë tema dhe lajme të lidhura me emigrantët, është që të shmangen gjatë ndërtimit të lajmeve referencat për kombësinë, përkatësinë etnike, fenë ose situatën ligjore, sa herë që këto nuk janë thelbësore për lajmin.

Por, me sa duket, ky sugjerim që në lajme të mos përmendet kombësia apo statusi i emigrantit, pasi krimet nuk kanë lidhje me kombësinë apo emigracionin në vetvete, nuk merret parasysh nga media. Referimi te kombësia, në rastin e tabloidit *Bild* duket se është tipar i përgjithshëm, pasi, sipas kërkimeve tona, rezultojnë se ka artikuj me referime dhe për kombësitë e tjera, si: për turqit, arabët etj.

Duhet theksuar fakti se në lajmet për krimet e shqiptarëve, nuk ka fjalë të tjera me ngjyime negative për ta, përveç referimit te kombësia. Një analizë e përmbajtjes u krye për të kategorizuar titujt dhe gjuhën e përdorur për të përshkruar emigrantët shqiptarë të përfshirë në lajmet e tabloidit *Bild*.

Duke vijuar me një analizë dhe më të thelluar në programin *Concordance 3.2*, për të parë frekuencën e përdorimit të fjalëve *Albaner*, *Albanien*, *Albanisch* në përmbajtjen e artikujve, vëmë re fjala *Albanien* përdoret pak më shumë sesa fjala *Albaner*, sikurse mund të shihet në tabelë.

Tabela 4. Frekuenca e përdorimit të fjalëve *Albaner*, *Albanien*, *Albanisch*

Fjala	Nr.
Albanien	53
Albaner	47
Albanisch	38

Nga analiza e artikujve të analizuar, rezulton se përdorimi i fjalës *Albanien* në më shumë raste është si rezultat i artikujve për zgjerimin e BE-së (a) ose i lajmeve nga Shqipëria, si p.sh. lajmet për demonstratën e opozitës në dhjetor 2022 (b), për sulmet kibernetike nga Irani (c), për problemet me *Call Centers* (d) etj.

12. <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/about>.

- a) *Um den EU-Beitritt von Staaten wie **Albanien**, Kosovo, Nordmazedonien und Serbien ging es gestern beim Westbalkan-Gipfel in der albanischen Hauptstadt Tirana.*

Për hyrjen në EU të shteteve si Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia ishte takimi i djeshëm për Ballkanin Perëndimor në kryeqytetin shqiptar Tiranë.

16.12.2022

- b) *Das war nicht nur ein Angriff auf mich, sondern auf die gesamte Opposition in **Albanien**.*

Ky nuk ishte një sulm për mua, por për të gjithë opozitën në Shqipëri.

07.12.2022

- c) ***Albanien** hat, nachdem Iran Cyberattacken auf Albanien gemacht hat, alle Verbindungen komplett gekappt.*

Shqipëria, pas sulmeve kibernetike nga Irani, i ka ndërprerë të gjitha lidhjet.

09.09.2022

- d) *Potenzielle Opfer wurden von Callcentern in **Albanien** und anderen Ländern aus kontaktiert.*

Viktimat e mundshme u kontaktuan nga Callcenters nga Shqipëria dhe nga vende të tjera.

22.11.2022

Në artikuj nuk mungojnë vlerësime të bëra për Shqipërinë si vend që prodhon krizë apo për situatat e tensionuara politike (e, f).

- a) ***Albanien** zählt zu den größten Krisenherden in Europa.*

Shqipëria konsiderohet si një nga vatrat më të mëdha të krizës në Evropë.

07.12.2022

- b) *Immer wieder kommt es in **Albanien** zu gewalttätigen Protesten.*

Sërish në Shqipëri ka protesta të dhunshme.

07.12.2022

Në disa raste përdorimi i fjalës *Albanien* është referim për vendin e origjinës së personave të përfshirë në krime (g, h).

- a) *Im August 2000 soll der Albaner Genc T. (42) mit seinem Vater nach BILD-Infos einen hochrangigen Polizeidirektor in Shkoder (Albanien) ermordet haben.*

Në gusht 2000, shqiptari Genc T. (42) me babanë e tij, duhet të ketë vrarë, sipas informacioneve të Bild-it një drejtor policie të nivelit të lartë në Shkodër (Shqipëri).

04.01.2022

- b) *Der Mann aus Albanien lernte 2019 sein späteres Opfer kennen.*
Burri nga Shqipëria e njohu në vitin 2019 viktimën e tij.

25.01.2022

Duhet të theksojmë faktin se përdorimin e fjalës *Albaner* (shqiptar), pra referimin të kombësia e hasim në lajmet sportive, ku Granit Xhaka përmendet 19 herë, kryesisht për shkak të situatës së tensionuar në ndeshjen mes Zvicrës dhe Serbisë më 2 dhjetor 2022. Titulli kryesor i tabloidit *Bild* e konsideron si provokim gjestin e Xhakës dhe e vendos në titullin kryesor. Në përmbajtje të artikullit ai konsiderohet për rolin e tij në skuadër: si lojtari kryesor (i), kapiten (i), yll i skuadrës (j), por dhe me referim si i lindur si shqiptar i Kosovës (Kosovo-Albaner) apo si lojtar i kombëtares zvicerane me rrënjë në Kosovë (k).

- a) *Der Gladbach-Retter von 2015 – da machte André Schubert seinen Führungsspieler Xhaka nach der Flucht von Lucien Favre zum Kapitän und erreichte mit dieser Maßnahme noch den Sprung von Platz 18 in die Champions.*

Shpëtuesi i Gladbach-ut që nga viti 2015- André Schubert e bëri lojtarin e tij kryesor Xhakën pas largimit të Lucien Favren si kapiten, dhe arriti me këtë masë kapërcimin nga vendi i 18-të në Champions.

05.12.2022

- b) *Damit könnten die Schweizer Stars Xherdan Shaqiri (31/ehemals FC Bayern) und Ex-Gladbach-Star Granit Xhaka (30) gemeint gewesen sein. Beide haben kosovo-albanische Wurzeln.*

Yjet e Zvicrës Xherdan Shaqiri (31/ish futbollist i FC Bayern) dhe ish-ylli i Gladbach-ut Granit Xhaka (30) mund ta kenë bërë me qëllim. Të dy kanë rrënjë shqiptaro-kosovare.

03.12.2022

- c) *Hat Xhaka, Schweizer Nationalspieler mit kosovarischen Wurzeln, die Gelbe Karte absichtlich abgeholt [...]*

A e ka marrë Xhaka, Lojtari i Kombëtares zvicerane me rrënjë shqiptare, kartonin e verdhë [...]

06.08.2022

Por në shumë raste fjala *Albaner* përdoret në lidhje me kombësinë e personave të përfshirë në krime të ndryshme, apo janë viktime të krimeve.

- a) *Nach den tödlichen Schüssen auf einen **Albaner** (42) in Krefeld hat die Polizei [...]*

Pas goditjes vdekjeprurëse ndaj një shqiptari në Krefeld, Policia ...

09.03.2022

- b) ***Der Albaner** war der Polizei wegen verschiedener Delikte (Drogenhandel, Diebstahl) bekannt.*

Shqiptari ishte i njohur për policinë për shkak të krimeve të ndryshme (tregtim droge, grabitje).

29.11.2022

Përfundime

Në këtë punim, analizuam diskursin për emigrantët në një nga mediat gjermane më me ndikim, në tabloidin *Bild*, duke u ndalur në mënyrën e përfaqësimit të shqiptarëve në një nga mediat gjermane më të ndjekura, dhe rezultatet tregojnë se media luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e imazhit pozitiv apo negativ të emigrantëve.

Rezultatet e këtij studimi mbështesin përfundimet e Maurer et al. se ashtu si dhe mediat e tjera në Gjermani, dhe tabloidi *Bild* trajton tema që lidhen me kriminalitetin e emigrantëve. Sikurse u theksua më lart, shqiptarët përmenden kryesisht në lajme për krime të ndryshme.

Në lajmet për krimet e shqiptarëve, por dhe në raste të tjera, bie sy përdorimi i përkatësisë kombëtare. Duhet theksuar fakti se në lajmet për krimet e shqiptarëve, nuk ka fjalë të tjera me ngjyrim negative për ta, përveç referimit të kombësisë.

Si një tabloid, *Bild* u jep dhe një vend sportistëve me origjinë shqiptare, për aktivitetet sportive ku ata janë përfshirë, duke i vlerësuar ata për kontributin e tyre. Mungojnë artikuj për artistë shqiptarë apo shqiptarë të suksesshëm në Gjermani.

Një studim krahasues me media të tjera gjermane dhe për një hapësirë kohore më të madhe, në të ardhmen, do të na japë një panoramë dhe më të gjerë të mënyrë së paraqitjes së shqiptarëve në median gjermane.

BIBLIOGRAFIA:

- ARAÚJO Alves, GILBERTO & GIZÉLIA Maria da Silva Freitas (2022), *A review on discourse studies concerning migrants in media publications from Brazil and South Africa: towards more Afro-Latin perspectives*, *index.comunicación* 12(1): 309-333. <http://hdl.handle.net/10115/18501>.
- BECKER, Maria (2015), *Der Asyldiskurs in Deutschland. Eine medienlinguistische Untersuchung von Presstexten, Onlineforen und Polit-Talkshows*, Frankfurt a. M.
- BURROUGHS, Elaine (2015), *Political and Media Discourses of Illegal Immigration in Ireland*. Baden-Baden: Nomos.
- FALK, Francesca (2010), *Invasion, infection, invisibility: An iconology of illegalized immigration*, In *Images of Illegalized Immigration. Towards a Critical Iconology of Politics*, edited by Christine Bischoff, Francesca Falk & Sylvia Kafehsy, 83-100. Bielefeld: transcript Verlag. <https://doi.org/10.14361/transcript.9783839415375.83>.
- FAIRCLOUGH, Norman (1995), *Critical Discourse Analysis*. London: Longman.
- FAIRCLOUGH, Norman (2000), *New Labour, New Language?* London and New York: Routledge.
- FOWLER, Roger (1991), *Language in the News: Discourse and Ideology in the Press*. London and New York: Routledge.
- HAIDER, Ahmad S. 2019. "Using corpus linguistic techniques in (critical) discourse studies reduces but does not remove bias: Evidence from an Arabic corpus about refugees." *Poznan Studies in Contemporary Linguistics* 55(1): 89-133. <https://doi.org/10.1515/psicl-2019-0004>.
- HERBERT, Ulrich (2017): *Geschichte der Ausländerpolitik in Deutschland. Saisonarbeiter, Zwangsarbeiter, Gastarbeiter, Flüchtlinge*. München.
- KRESS, Gunther (1986), *Language in the Media: The Construction of the Domains of Public and Private*, *Media, Culture & Society* 8(4): 395-419 <https://doi.org/10.1177/0163443786008004003>.
- KRESS, Gunther and Theo Van Leeuwen (2001), *Multimodal Discourse: The Modes and Media of Contemporary Communication*. London: Arnold.
- MAUER M., JOST P., Kruschinski S., Haßler Fünf Jahre Medienberichterstattung über Flucht und Migration. F.3. Policy_Paper_Migration.indd (stiftung-mercator.de)
- SEELIGER, Henriette-Juliane (2018), *Trapped Outside the History House: Language, History, and Belonging in three Generations of (Post-)Colonial Subjects*, in *esse: English Studies in Albania* 9(2):43-63.
- SEPPÄLÄ, Tiina (2022), *No One is Illegal, As a Reverse Discourse Against Deportability.* *Global Society* 36(3), 391-408. <https://doi.org/10.1080/13600826.2022.2052023>.
- SILVEIRA, Carolina (2016), *The Representation of (Illegal) Migrants in The British News, Networking Knowledge: Journal of the MeCCSA Postgraduate Network* 9(4): 1-16. <https://doi.org/10.31165/nk.2016.94.449>.
- TEO, Peter (2000), *Racism in the news: A critical discourse analysis of news reporting in two Australian newspapers*, *Discourse C Society* 11(1): 7-49.
- VAN Dijk, TEUN A. (1983). *Discourse analysis: its development and application to the structure*

of news, në *Journal of Communication*, 33(1): 20-43. doi.org/10.1111/j.1460-2466.1983.tb02386.x.

VAN DIJK, TEUN A. (1984), *Prejudice in discourse*. Amsterdam: Benjamins.

VAN DIJK, TEUN A. (1987), *Mediating racism: the role of the media in the reproduction of racism*, në *Language, power and ideology*, edited by Ruth Wodak, 199-226. Amsterdam: Benjamins.

VAN DIJK, TEUN A. (1991), *Racism and the Press*. London and New York: Routledge.

VAN DIJK, TEUN A. (2015), *Critical Discourse Analysis*, në *The Handbook of Discourse Analysis*, edited by Deborah Tannen, Heidi E. Hamilton, and Deborah Schiffrin, 466-485. Hoboken: John Wiley & Sons, Inc.

VAN DIJK, TEUN A. (2018), *Discourse and Migration*, në *Qualitative Research in European Migration Studies*, edited by Ricard Zapata-Barrero and Evren Yalaz, 227-245. [10.1007/978-3-319-76861-8_13](https://doi.org/10.1007/978-3-319-76861-8_13).

VAN LEEUWEN, THEO & ADAM JAWORSKI (2003), *The discourses of war photography: photo journalistic representations of the Palestinian-Israeli war*, *Journal of Language and Politics* 1(2): 255-275. doi.org/10.1075/jlp.1.2.06lee.

WALTER, William (2010), *Imagined Migration World: The European Union's Anti-Illegal Immigration Discourse*, në *The Politics of International Migration Management. Migration, Minorities and Citizenship.*, edited by Martin Geiger and Antoine Pécoud, 73-95. London: Palgrave Macmillan. https://doi.org/10.1057/9780230294882_4.

WODAK, Ruth (1996a.), *The genesis of racist discourse in Austria since 1989*, në *Texts and Practices: Readings in Critical Discourse Analysis*, edited by Carmen Rosa Caldas-Coulthard and Malcolm Coulthard, 107-128). London and New York: Routledge.

WODAK, Ruth (1996b.), *Others in discourse – Racism and antisemitism in present day Austria*, *Research on Democracy and Society* 3(1): 275-296.

WODAK, Ruth (2000), *We demand that foreigners adapt to our lifestyle: political discourse on immigration laws in Austria and the United Kingdom*, në Wodak R. et al. (ed.). *Combating Racial Discrimination* (pp. 217-237). Oxford: Berg.

WODAK, Ruth & THEO VAN LEEUWEN (1999), *Legitimizing immigration control: a discourse-historical analysis*, *Discourse Studies*, 1(1): 83-119. doi.org/10.1177/1461445699001001005.

ZAMBONINI G. *The evolution of German Media Coverage of migration* <https://www.migrationpolicy.org>.

SITOGRAFIA

<https://albania.iom.int/migration-and-albania>.

<https://www.statista.com/statistics/1253252/albanian-population-in-united-kingdom>.

Eurostat: Rreth 110 mijë shqiptarë jetojnë në Francë e Gjermani - Shqiptarja.com.

<https://politiko.al/english/e-tjera/shqiptaret-perbejne-18-te-totalit-te-azilkerkuesve-ne-be-kryeson-franca--i477936>.

24.3% of the population had a history of immigration in 2022 - German Federal Statistical Office (destatis.de)

<https://www.euronews.com/my-europe/2023/03/09/german-cities-struggling-with-winter-influx-of-migrants>.

<https://www.auswaertiges-amt.de/en/aussenpolitik/kosovo/228088>.

http://www.fact-index.com/b/bi/bild_zeitung.html.

<https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/about>.